



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr.01

Prishtinë, më 10.10.2017, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S1

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Albulena Haxhiu, Korab Sejdiu, Shkumbin Demaliaj, Bilall Sherifi, Arben Gashi, Hajdar Beqa dhe Bahrim Shabani.

Munguan: Agim Aliu, Sami Kurteshi, Glauk Konjufca, Jelena Bontiq.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Lumturie Bekaj- KOSOVA.INFO; Blend Zyrapi-KIPRED; Sanije Berisha-OSBE; Qëndrim Bytyçi- FOL; Gresa Smolica-LËVIZJA FOL; Muhamed Shehu-KOSOVA SOT; Valmira Saraçi- KTV; Dren Ajeti-GSJP.

Stafi mbështetës i komisionit: Visar Krasniqi, Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

Mbledhjen e kryesoi, Albulena Haxhiu, kryetare e komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Konstituimi i komisionit;
3. Diskutim lidhur me aktivitetet e komisionit;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja propozoi që të shqyrtohet edhe rekomandimi i Avokatit të Popullit, nr. 582/2017 dhe t'i kthehet një përgjigje në përputhje me afatin ligjor që është përcaktuar.

Kryetarja konstatoi se rendi ditës u miratua me ndryshimet e propozuara.

2. Konstituimi i komisionit

Kryetarja përshëndeti anëtarët e Komisionit dhe pjesëmarrësit e tjerë dhe i njoftoi me Vendimin e Kuvendit nr.06-V-006, datë 3.10.2017, i cili ka përcaktuar përbërjen e komisionit si vijon:

Albulena Haxhiu-kryetare

Hajdar Beqa-zëvendëskryetar i parë

Bahrim Shabani-zëvendëskryetar i dytë

Glauk Konjufca-anëtar

Sami Kurteshi-anëtar

Arben Gashi-anëtar

Korab Sejdiu-anëtar

Agim Aliu-anëtar

Jelena Bontiq-anëtare

Shkumbin Demaliaj-anëtar

Bilall Sherifi-anëtar.

Lidhur me këtë pikë, komisioni nxori këtë:

PËRFUNDIM

U konstituua komisioni, në pajtim me Vendimin e Kuvendit, nr.06-V-006, datë 3.10.2017.

3. Diskutim lidhur me aktivitetet e komisionit

Kryetarja, tha se sa i përket kësaj pike të rendit të ditës, duke iu referuar Rregullores së Kuvendit, është e ditur se me pushimin e mandatit të Kuvendit, të gjitha punët e mbetura kthehen në pikën zero dhe pikërisht për këtë çështje kemi pranuar një shkresë nga Avokati i Popullit, i cili kërkon nga Komisioni për Legjislacion, ndryshimin e nenit 86 të Rregullores së Kuvendit, ku thuhet “të gjitha çështjet të cilat mbesin në procedurë konsiderohen të përfunduara”, meqenëse kemi afatin e caktuar dhe duhet t’i kthehet një përgjigje Avokatit të Popullit. Përgjigjja është përgatitur, me qëllim që në kohën kur Komisioni për Legjislacion të fokusohet te ndryshimi i

Rregullores së punës së Kuvendit, atëherë të diskutohet edhe kërkesa që është ngritur nga Avokati i Popullit.

Në vazhdim, njoftoi anëtarët me punët që kanë mbetur pa përfunduar nga Komisioni për Legjislacion: 1. Një anëtar që kërkon Shoqata e të Burgosurve Politikë në Komisionin Qeveritar për njohjen e statusit të ish- të dënuarve dhe ish- të përndjekurve politikë, ku tha se në këtë komision duhet të jetë edhe një anëtar nga Komisioni për Legjislacion. 2. Kompletimi i Këshillit Prokurorial të Kosovës me tre anëtarë, znj. Haxhiu sqaroi se një anëtar duhet të jetë nga shoqëria civile, një nga Oda e Avokatëve dhe një nga Fakulteti Juridik. Si pikë tjetër, tha se është formimi i grupit punues për mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe formimi i grupit punues për Rregulloren e punës së Kuvendit. Gjithashtu, çështje tjetër që u përmend nga deputetja Albulena Haxhiu ishte lidhur me raportet e institucioneve të pavarura, të cilat kanë për obligim të raportojnë para Komisionit për Legjislacion për punën njëvjeçare të tyre, ku sqaroi se për shkak të zgjedhjeve në vend, këto raporte kanë mbetur të pashqyrtuara. Ndërsa sa i përket planit të punës, deputetja Haxhiu tha se nuk mendon që të bëhet një plan i punës, kur dihet se vetëm edhe dy muaj e gjysmë kanë mbetur deri në përfundim të këtij viti. Ajo propozoi që të veprohet varësisht nga Plani legjislativ apo propozimeve që i sjell Qeveria në Kuvend dhe gjithashtu theksoi se duhet të punohet në çështje që u diskutuan paraprakisht.

Hajdar Beqa, tha se Plani i punës së komisionit duhet të jetë në harmonizim me Planin e Qeverisë, por edhe me nisma tjera që mund të marrin deputetët apo qytetarët. Pavarësisht që përfaqësojmë subjekte të ndryshme politike, konsideroj që puna duhet të kryhet në mënyrë sa më profesionale, të ketë unitet në vendime që do të merren. Komisioni për Legjislacion është i rëndësishëm, dhe duke pasur parasysh që është humbur shumë kohë, mendoj që duhet të ngutemi me agjendën e komisionit, prandaj duhet të ketë një plan për punën e komisionit, për këta muaj që kanë mbetur.

Korab Sejdiu, tha se punët e mbetura që u paraqitën nga kryetarja, mendoj se janë me prioritet, veçanërisht çështja e Këshillit Prokurorial. Gjithashtu, edhe çështja e ngritur nga Avokati i Popullit, është mirë që brenda afatit të kthehet përgjigjja, ku duhet të potencohet që do të merret në shqyrtim kjo çështje në procedurën për amendamentimin e Rregullores së re. Sa i përket Rregullores, tha se ka pasur vërejtje të mëdha. Pra, duke pasur parasysh këtë, mendoj që kjo duhet të jetë prioriteti ynë kryesor dhe të bëhet në një kohë sa më optimale, theksoi në fund z. Sejdiu.

Sa i përket grupit punues për mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe grupit punues për Rregulloren e punës, të gjithë u pajtuan me propozimin e deputetes Haxhiu, që njëri grup punues të udhëhiqet nga pozita, ndërsa tjetri grup punues nga opozita. Gjithashtu u pajtuan që propozimet për kryesues dhe anëtarë të grupeve punuese të mbeten për diskutim në mbledhjen e radhës.

Hajdar Beqa, kërkoi që të njoftohen edhe me shkrim për agjendën që ka pasur komisioni për punët e papërfunduara, ndërsa sa i përket raporteve të agjencive të pavarura, theksoi se duhet të shqyrtohen në komision e më pas të vendoset për procedim.

4. Të ndryshme

Shqyrtimi i shkresës së Avokatit të Popullit, e datës 12.9.2017, që ka të bëjë me rastin nr. 582/2017

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit, shqyrtoi raportin e Avokatit të Popullit, të datës 12.9.2017, që ka të bëjë me rastin nr.582/2017.

Komisioni vlerësoi se adresimi i rekomandimit të Avokatit të Popullit, që i referohet nenit 86 të Rregullores së Kuvendit, i cili flet për punët e pambaruara në këtë fazë, është i pamundur. Neni 86 i Rregullores ka këtë normim dhe si të tillë Kuvendi e zbaton, derisa i njëjti të ndryshohet.

Kjo çështje do të trajtohet nga Komisioni për Legjislacion, në momentin kur komisioni do të fillojë punën për ndryshimin e Rregullores së Kuvendit. Për më tepër, do të ftohet përfaqësuesi institucionit tuaj, që të marrë pjesë në takimet e grupeve punuese dhe në mbledhjet e komisionit, ku do të diskutohet në lidhje me Rregulloren e re të punës së Kuvendit.

Në fund u vendos që mbledhjet e komisionit të mbahen ditën e martë, në ora 13:00.

Mbledhja përfundoi në orën 13:20.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetare e komisionit,

Albulena Haxhiu